



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 562/8 Prot.

Tiranë, më 12/5/2017

V E N D I M

Nr. 70, datë 12/5/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të përpunuesit "**Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k**".

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 83, datë 24.03.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë përpunuesit "**Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k**", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve e ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në kuadër të përpunimit të të dhënave gjatë implementimit të projektit "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

"Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k" ka nënshkruar marrëveshjen me OSHEE nëpërmjet të cilës ndërmerr të gjitha veprimet për të realizuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë në emër dhe për llogari të kësaj të fundit (në mënyrë elektronike dhe manuale). Në bazë të nenit 3/7 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kjo kompani konsiderohet "përpunues".

Hetimi pranë këtij përpunuesi u iniciua nga Zyra e Komisionerit bazuar në indiciet/ankesat e ardhura nga qytetarë të ndryshëm dhe publikimet në median audio-vizive dhe atë të shkruar. Ky hetim u vlerësua si mjaft i rëndësishëm për shkak të sasisë së madhe të të dhënave personale dhe interesit publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

1. Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ konstatoi se "**Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi**

sh.p.k”, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve si përpunues (në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887/2008):

- Nuk ka informuar kontrolluesin (OSHEE) mbi kontratat e lidhura me “agjencitë e punësimit” të cilave u është deleguar mbledhja e të dhënave personale në terren (pika 1/a e këtij neni);
- Në këtë kuadër nuk janë zbatuar detyrimet e parashikuara në pikën 6 dhe 10 të Udhëzimit nr.19, datë 03.08.2012 mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar, miratuar nga Komisioneri.
- Nuk ka krijuar kushtet teknike dhe organizative për të garantuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (pika 1/c e këtij neni);

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i kontrolluesit mbi delegimin e përpunimit është mjaft i rëndësishëm pasi kontrolluesi është përgjegjës për kontrollin e nivelit të sigurisë së të dhënave personale që përpunohen për llogari të tij nga përpunuesi dhe kompanitë e kontraktuara nga ky i fundit. Niveli i sigurisë së kompanive të kontraktuara nga përpunuesi nuk duhet të jetë më i ulët se ai i përcaktuar mes kontrolluesit dhe përpunuesit.

Të drejtat e subjekteve të të dhënave duhet të garantohen në çdo rast dhe në të njëjtin nivel si nga kontrolluesi dhe nga përpunuesi. Garantimi i të drejtave të subjekteve garanton përpunimin e ligjshëm, të saktë dhe të drejtë të të dhënave personale.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e përpunuesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

2. Zyra e Komisionerit konstatoi se “*Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consorzio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k*” nuk kishte hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të subjekteve të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Edhe në kontratat që përpunuesi ka lidhur me “agjencitë e punësimit” të cilave u është deleguar mbledhja e të dhënave personale në terren nuk janë parashikuar rregulla dhe detyrime mbi garantimin e sigurisë fizike dhe teknike dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Në inspektimet e ndërmarra në vijim pranë këtyre kompanive u konstatua që prej tyre nuk ishin ndërmarrë masa për sigurinë fizike të të dhënave personale që mbliidhen nëpërmjet formularëve të adresarit. Gjithashtu u konstatua se këto kompani nuk kishin hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

Detyrimi për garantimin e sigurisë së të dhënave personale zbatohet njësoj si ndaj përpunuesit edhe ndaj kompanive të kontraktuara prej tij. Në këtë rast përpunuesi është përgjegjës edhe për

masat e sigurisë së të dhënave personale, që duhet të zbatohen nga kompanitë e tjera të cilat u ka deleguar përpunimin.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale të qytetarëve/klientëve. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave).

3. Sistemi i informacionit për administrimin e bazës së të dhënave të krijuar në kuadër të projektit të Adresarit është vendosur në zyrat qendrore të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE), ku realizohet grumbullimi i të dhënave, përditësimi dhe rakordimi i tyre.

Të dhënat e grumbulluara përmes tablet-it të intervistuesit regjistrohen në DataCenter-in (server, *storage* qendror fizik) të BOE-së. Ky server garanton kapacitetin e nevojshëm për të ruajtur informacionin në kohë reale dhe mos-ndërprerjen e punës përmes backup-eve periodik.

Në nivel lokal, informacioni i grumbulluar në Datacenter, transmetohet përmes pajisjeve të lëvizshme "Tablet" në platformën android, në të cilat është instaluar aplikacioni *GoAdresari*. BOE, ofron materiale trajnuese për intervistuesit, lidhur me përdorimin e pajisjes Tablet dhe aplikacionit *GoAdresari*, për realizimin e një interviste. Intervistuesi përpara fillimit të punës në terren logohet tek aplikacioni. Të dhënat që grumbullohen përmes aplikacionit në tablet janë të enkriptuara dhe asnjë person që ka tabletin nuk mund ti aksesojë ato.

Aplikacioni përdor sinjalin e GPS për të raportuar në lidhje me vendndodhjen e grupit të punës. Aplikacioni përdor transmetimin e të dhënave përmes rrjetit 3G/4G të operatorit Albtelecom, për të transmetuar në qendër të dhënat e mbledhura gjatë punës në terren. Ky transmetim është i koduar dhe realizohet përmes një rrjeti të veçantë privat VPN, të izoluar nga interneti. Të dhënat e grumbulluara përmes tablet-it të intervistuesit sinkronizohen me sistemin qendror të BOE-së (Datech).

Sistemi përmes ndërfaqeve të posaçme ofron raporte të ndryshme mbi mënyrën si autoriteti kontraktor kontrollon cilësinë e punës dhe ecurinë e gjithë procesit.

Përmes *web-service* (ndërfaqe komunikimi), sistemi i ngritur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ndërlidhet me Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) si dhe Databazën e Operatorëve të OSHEE. Është programuar lidhja automatike e të dhënave të marra nga formularët (tablet) me sistemin aktual GIS të MB-së (RKA-ja). Lidhja automatike me RKGJC është e mundur nga numrat personalë të shtetasve, të cilët gjenden në kartat e identitetit të shtetasve (skanimit me tablet i kartës së identitetit të personit, i paraprin plotësimin të gjithë formularit). Lidhja e të dhënave me Databazën aktuale të OSHEE, realizohet duke përdorur si element-lidhës numrin e kontratës. Gjithashtu, aplikacioni ka integruar pjesën e identitetit të bizneseve, NIPT, nëpërmjet të cilëve bëhet lidhja direkte me bazën e të dhënave të QKR-së.

Baza e të dhënave ruhet në ambientet e kontraktorit (BOE-së) dhe ndërkohë është vënë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues dhe atij Përlitues (OSHEE dhe Ministria e Punëve të Brendshme) një link me kredenciale me qëllim që ata të kenë akses të drejtpërdrejtë vetëm tek

të dhënat e punëve të realizuara. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga sistemi i krijuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, në përfundim të këtij projekti, do të ruhen në një databazë të veçantë, të pavarur nga sistemet e tjera dhe pas verifikimeve përkatëse dhe kontroleve të cilësisë, çdo e dhënë e mbledhur do të transferohet në sistemet përkatëse të OSHEF-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Zyra e Komisionerit konstatoi se nga ana e “*Bashkimit të Operatorëve CSI Piemonte-Consorzio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k*” nuk janë ndërmarrë masa për trajnimin e personave/punonjësve të angazhuar për të mbledhur të dhënat personale, lidhur me parimet e mbrojtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, masat e sigurisë së të dhënave dhe konfidencialitetin, në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 24/09/2012 për “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, i ndryshuar.

Në manualët e hartuara dhe miratuara nga përpunuesi nuk janë parashikuar parimet dhe rregullat mbi mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve shqiptarë sanksionuar në ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, (me qëllim implementimin e tyre në praktikë) por janë parashikuar vetëm procedurat teknike për përcaktimin e adresave dhe përdorimin e tabletit nëpërmjet të cilit regjistrohen të dhënat.

Mbledhja e të dhënave personale nga punonjësit e kontraktuar është një fazë mjaft e rëndësishme e procesit të përpunimit pasi përbën momentin e kontaktit të drejtpërdrejtë të subjektit të të dhënave personale (qytetarit) me kontrolluesin dhe përpunuesin. Rëndësia qëndron në faktin se është pikërisht ky moment që i jep mundësinë subjektit të të dhënave personale të informohet mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të tij personale, kush i përpunon ato, të drejtat që gëzon, afatin e ruajtjes dhe masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, të cilat janë detyrime konkrete që ka kontrolluesi dhe përpunuesi.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se është mjaft i rëndësishëm trajnimi i punonjësve të angazhuar në terren me qëllim që të përcillet fryma e respektimit të ligjit dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit (datë 04.04.2017), si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, në datën 18/04/2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e përpunuesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesit e përpunuesit gjatë seancës dëgjimore kanë depozituar prapësime në lidhje me konstatimet në procesverbalin e hetimit administrativ, ku pretendojnë se:

- Janë dakort me cilësimin si përpunues, referuar në pikën 1 të procesverbalit të hetimit, në bazë të nenit 3/7 të Ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
- Nuk kanë transmetuar dhe as deleguar përpunimin e të dhënave në “agjencitë e punësimit” që kanë kontraktuar. Lidhur me krijimin e kushteve teknike dhe organizative për garantimin

e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale është paraqitur pretendimi se "të gjitha kushtet teknike dhe organizative sipas nenit 20 të Ligjit 9887/2008, Pika 1/c janë përcaktuar në marrëveshjen me kontrolluesin dhe konkretisht në Aneksin nr.2 të Kontratës, "Specifikimet Teknike Ministria e Punëve të Brendshme dhe Termat e Referencës OSHEE sha".

- Rregullat specifike bazuar në nenin 27 të Ligjit 9887/2008, janë parashikuar në mënyrë të detajuar në Aneksin nr.2 të Kontratës. "Specifikimet Teknike Ministria e Punëve të Brendshme dhe Termat e Referencës OSHEE sha", nga e cila rrjedhin dhe rregullat specifike që duhet të përmbushen nga BOE. Në mbështetje të këtyre kërkesave specifike, BOE ka informuar kontrolluesin për masat që janë marrë në zbatim të tyre, me anë të Raportit "Mbi Ngritjen e Infrastrukturës" me nr. 21411 datë 06.12.2016, ku të dhënat janë paraqitur në mënyrë të detajuar në Kapitullin "Teknologjia e Projektit".
 - Sa i përket konstatimit lidhur me parashikimin e rregullave dhe detyrimeve mbi garantimin e sigurisë fizike dhe teknike dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në kontratat që përpunuesi ka lidhur me agjencitë e punësimit, vlejnë argumentet se në "agjencitë e punësimit" që kanë kontraktuar nuk janë transmetuar dhe as nuk është deleguar përpunimi i të dhënave.
 - Sa i përket masave për trajnimin e punonjësve, janë përgatitur Manuale të detajuara për mënyrën se si duhet të procedohet lidhur me marrjen e informacionit në terren, si kërkohet informacioni dhe si duhet të sillen punonjësi me shtetasin.
 - Të gjitha procedurat e ndjekura nga BOE, janë në mbështetje me kërkesat teknike të përcaktuara në Kontratën me nr.6078/9, datë 29.09.2016, si dhe në mbështetje të nenit 5/1/a të ligjit nr. 9887/2008.

Lidhur me pretendimet e paraqitura Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Agjencitë e punësimit të kontraktuara nga "Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consorzio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k" kryejnë përpunim të të dhënave personale të qytetarëve në referim të përkufizimit të termit "Përpunim i të dhënave personale", parashikuar në nenin 3/12 të ligjit nr. 9887/2008. Personat që mbledhin të dhënat personale në mënyrë manuale dhe elektronike janë kontraktuar dhe janë punonjës të këtyre agjencive.
- Nuk janë marrë masa teknike dhe organizative sa i përket garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (të drejtën për të aksesuar, bllokuar, korrigjuar, fshirë, kundërshtuar, për tu ankuar dhe kërkuar kompensim në rast dëmi, sipas neneve 12-17 të ligjit nr. 9887/2008). Garantimi i këtyre të drejtave është kusht bazë për një përpunim të ligjshëm.
- Specifikimet teknike referuar nga përpunuesi nuk realizojnë tërësisht qëllimin e ligjit nr.9887/2008 pasi nuk garantojnë të gjithë elementët e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë dhe nuk është gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave). Nuk parashikohen masa për sigurinë fizike të formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga qytetarët. Mungesa e masave për trajnimin e punonjësve mbi detyrimet që parashikon legjisllacioni në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mungesa e masave të sigurisë për "agjencitë e punësimit" të kontraktuara për kryerjen e shërbimit në terren eënon sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat "ç" dhe "dh" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Përpunuesi "Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k", në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh interesin publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të implementimit të projektit, sasinë e madhe të të dhënave të përpunuara, faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze dhe lidhen me masat organizative dhe teknike të përshtatshme që duhet të merren për të mbrojtur të dhënat personale, realizimin e detyrimeve të përpunuesit ndaj kontrolluesit, si dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe në reagimin e përpunuesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 20, 27, 29, 30, 31, 39/1/ç, 39/1/dh, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e përpunuesit "Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k" me gjobë, në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore:

- Të informohet kontrolluesi (OSHEE) mbi kontratat e lidhura me "agjencitë e punësimit" të cilave u është deleguar mbledhja e të dhënave personale në terren;
- Të krijohen kushtet teknike dhe organizative për të garantuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (parashikuar në nenet 12-17 të ligjit);
-

2. Dënimin e përpunuesit "Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consortio per il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k" me gjobë, në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar;

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore:

- Të hartohet dhe miratohet një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të subjekteve të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj;
 - Në kontratat e lidhura me "agjencitë e punësimit" të cilave u është deleguar mbledhja e të dhënave personale në terren të parashikohen rregulla dhe detyrime mbi garantimin e sigurisë fizike dhe teknike të të dhënave personale;
3. Në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 24/09/2012 për "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha", i ndryshuar, të merren masa për trajnimin e personave/punonjësve të angazhuar për të mbledhur të dhënat personale, lidhur me parimet e mbrojtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, masat e sigurisë së të dhënave dhe konfidencialitetin.
 4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara më sipër, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
 5. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 12 . 5 2017.

